

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zabeli kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.P., nga fshati ..., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, P.nr.450/2017 të datës 06.06.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur, më 22.08.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, P.nr.450/2017 të datës 06.06.2019, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin P.nr.450/2017 të datës 06.06.2019, të akuzuarin F.P., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK- së dhe e ka gjykuar me dënim gjobë në lartësi prej 700 (shtatëqind) €, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në xhirollogarinë e gjykatës së shkallës së parë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të aktgjykimit të ankimuar, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burg, në kohëzgjatje prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh, duke llogaritur 20 (njëzet) € të gjobës në një ditë burgu. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë konform dispozitave të nenit 374 par. 3 të KPRK-së, të akuzuarit i konfiskohen arma “pushkë e gjuetisë” prodhim turk, me numër serik 57178, si dhe dy fishekë të kalibrit 12.7mm, si mjete me të cilat është kryer vepra. Po ashtu, obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës tia paguajnë shumën prej 30 euro, kurse shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur, si dhe 30 euro për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit të ankimuar, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar ashtu që ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim më i rënd, me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.1024/2019 më datën 19.08.2019, ka propozuar që të aprovohen si të bazuara ankesat e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënimin, në mënyrë që të akuzuarit ti shqiptohet dënim i rëndë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- Ankesa nuk është e bazuar

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarës.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, në fakt me ankesë as që ka mund të kontestohet ngase i akuzuar F.P. në shqyrtimin fillestarë gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë me anë të aktit akuzues dhe gjyqtari individual është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimi i kundërshtuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve të paraqitura në ankesë.

Sa i përket vendimit mbi dënimin në ankesë prokurori pretendon se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike në rastin konkret, mirëpo e njëjta gjykatë, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim tejet të butë, për faktin se dënimi me gjobë nuk është adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmit të vlerës së mbrojtur. Gjithashtu, prokurori në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit ka marrë për bazë një mori rrethanash lehtësuese, siç janë : sjellja korrekte gjatë gjykimit, se është hera e parë që i akuzuari ndeshet me ligjin, se ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, se i vjen keq për rastin e ndodhur, ndërsa si rrethana rënduese nuk ka

gjetur, e që për këtë fakt prokurori i shtetit konsideron se në rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin është dashur ta merr faktin se këto vepra janë në rritje e sipër dhe rreziku nga armët është tejet i lartë dhe dënimi i shqiptuar aspak nuk i përgjigjet peshës së veprës penale. Po ashtu, pretendon se ky dënim i shqiptuar jo vetëm që nuk është në proporcion me peshën e veprës penale, por i njëjti nuk do ta arrij qëllimin dhe efektin e një dënimi meritore, si dhe do të ndikoj negativisht në opinion dhe do të inkurajoj të tjerët që të sillen në këtë mënyrë.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e prokurorit për shqiptimin e një dënimit me rëndë ndaj të akuzuarit, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka pasur parasysh se vepra penale, mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, e cila është sanksionuar me dënim me gjobë 700 (shtatëqind) € dhe në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 69 të KPRK-së. Gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimit, si rrethana rënduese ndaj të akuzuarit nuk ka gjetur, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, mori pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij, se është baba i 4 fëmijëve, mbajtës i familjes prej 9 anëtarëve, se asnjëri nuk është i punësuar, se është i gjendjes së dobët ekonomike, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, sjelljen korrekte në shqyrtim, si dhe se nuk është përsëritës i veprave penale.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar faktin se në ankesën e prokurorit, nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më të rëndë. Kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprës penale, e duke pasur parasysh se i akuzuari është gjykuar me dënim sikurse në dispozitivin e aktgjyqimit të ankimuar, e njëjta gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim më dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr. 1008/19 me datë 22.08.2019

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:
Shqipe Qerimi
Ferit Osmani